




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.41/2024
Datë: 22 shkurt 2024

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 4 dhe nenit 6 të Rregullores Nr.13/2022 Për Vlerësimin e Performancës të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikqyrës, në takimin 321-të, të mbajtur me datë 22 shkurt 2024, merr këtë:

V E N D I M

- I. Themelohet komisioni ad hoc për vlerësimin e performancës së z. Valon Totaj, kryetar në Gjykatën e Apelit, në përbërjen si në vijim:
 1. Teuta Ibrahim, anëtare e KGJK-së/kryetare e Komisionit;
 2. Avni Mehmeti, anëtar i KGJK-së/anëtar i Komisionit;
 3. Ahmet Imami, anëtar i KGJK-së/anëtar i Komisionit;
 4. Vilard Bytyqi, anëtar i KGJK-së/anëtar rezervë i Komisionit;
 5. Artan Abazi, anëtar i KGJK-së/anëtar rezervë i Komisionit.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 22 shkurt 2024.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës me datë 23 janar 2024, ka pranuar shkresë nga Kryetarja e Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve që vlerësimi i performancës duhet të bëhet për z. Valon Totaj, i cili aktualisht e ushtron funksionin e kryetarit në Gjykatën e Apelit.

Këshilli, në takimin e mbajtur më 22 shkurt 2024, pas shqyrtimit të shkresës përkatësisht kërkesës së kryetares së KVPGj, konform nenit 4 të Rregullores Nr.13/2022 Për Vlerësimin e Performancës të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikqyrës, ka themeluar Komisionin vlerësues në përbërjen si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ



Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit;
- Kryetarit të Gjykatës së Apelit;
- Njësisë për Inspektim Gjyqësor dhe Arkivit.